

VENDIM
Nr. 389, datë 21.10.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS GRAMSH SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-ja nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 21.10.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Gramsh sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Gramsh (U Gramsh), me shkresën nr. 576 prot., datë 30.9.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të U Gramsh në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria U Gramsh ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 25 280 banorë të Bashkisë Gramsh;
b) drejtues teknik i shoqërisë z. Bledjan Koçi është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës në Fakultetin e inxhinierisë së Ndërtimit dega “Hidroteknike” në vitin 2017;

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e U Gramsh, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e U Gramsh është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Gramsh sh.a., me (NUIS J66702809R), në kategoritë:

a) kategoria A – “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”.

2. Shoqëria Ujësjellës Gramsh sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

- a) drejtues ligjor – Tajar Bici;
 - b) drejtues teknik – Bledjan Koçi.
 - 3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës Gramsh sh.a. është Bashkia Gramsh.
 - 4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
 - 5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës Gramsh sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
 - 6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës Gramsh sh.a. për marrjen e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani